



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

**DREJTORATI PËR BUJQËSI , PYLLTARI DHE ZHVILLIM RURAL**

**Reference: 12-320**

<b>Datë:</b>	<b>06.04.2017</b>
<b>Për:</b>	<b>z.Imri AHMETI - Kryetar i Komunës së Lipjanit</b>
<b>Nga:</b>	<b>Feti KRASNIQI -Drejtore i Drejtoratit për Bujqësi , Pylltari dhe Zhvillim Rural</b>
<b>Lënda:</b>	<b>Raporti mujor i punës për muajin Mars : 2017</b>

**Shtojcë:** Raporti i aktiviteteve të Drejtoratit për Bujqësi , Pylltari dhe Zhvillim Rural për muajin Mars: **2017**

## **DBPZHR ne Lipjan gjatë muajit Mars 2017 , ka zhvilluar këto aktivitete :**

### **Aktivitete profesionale :**

- Takimet javore në Bordin e Drejtorëve
- Takimet me stafin lidhur me detyrat dhe përgjegjësitë në punë (Rastet në sektorin e pylltarisë , lista e vijueshmërisë , plani i shfrytëzimit sa me racional te buxhetit ).
- DBPZHR, ka punuar me orar të zgjatur të punes për të proceduar cdo terkes të fermerëve për subvencione të MBPZHR.
- Ka vazhduar procedimi i lëndeve për pagesat direkte 2017 , të shpallura nga MBPZHR.
- DBPZHR- ka derguar në sektorin e kuvendit materialin për dy pika të rendit të dites: njëra ka të bëjë me subvencionet komunale 2017 plani i destinimit të ketyre subvencioneve , dhe e dyta ka të bëjë me themelimin e dy vendëgjuetive në komunën e Lipjanit.
- Po ashtu me organizatën “TIKA” kemi biseduar për bashkëpunim dhe kemi premtime se do të përkrahemi nga kjo organizatë në sektorin e perimikultures.
- Në aspektin e trajtimit të qenëve endacak kemi vizituar sacionin veterinar në Lipjan , mandej kemi vizituar edhe një qender te trajtimit të qenve endacak me lokacion në fshatin Grackë.Qellimi i vizites ishte vlerësimi i nje dinamike te perbashket per te zbutur shqetësimet e popullates lidhur me prezencen e shtuar te qenëve endacak nëper rrugët , dhe vendbanimet e ndryshme të komunes së Lipjanit.
- Kemi vizituar mbi 60 bletar të komunes , te cilet kanë kërkuar nga ne , vlerësimin faktik të bletishteve të tyre në teren.
- Kemi mbajtur takime me perfaqesues të APK, me qellim të pyllëzimeve në terrenet e Lipjanit , si mundesi e donacioneve nga USAID.
- DBPZHR-ka përgatitur edhe planin e mbjelljeve pranverore 2017.
- Komisioni perkates i Drejtoratit për bujqësi ka vlerësuar edhe fermer të cilet kanë parashtruar kërkesat e tyre per dalje në vendëshikim, per to jan hartuar procesverbalet e vlerësimeve.
- Veshtiresi e DBPZHR, po mbetet mungesa e një automjeti , që eshte i domnosdoshem për efikasitetin e punes në teren.